

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE VLERESIMIT TE
NDIKIMIT NE MJEDIS PER FUNKSIONIMIN:**

**"IMPJANT PRODHIM BETONI NE FUNKSION TE HEC-
DRAGOBISE"**

Vendodhja : Prane Fshatit Shoshan, Njesia
Administrative Margegaj, Bashkia Tropoje,
Qarku Kukës

Kërkues: Subjekti: "Garden Line" Sh.p.k

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k

Administrator
Elidiana Shehu



Altin Ahmeti
(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014)

Ing. Elidiana Shehu
(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)

A blue ink signature of Altin Ahmeti.

A blue ink signature of Ing. Elidiana Shehu.

Maj, 2017

TABELA PERMBLEDHESE

1	HYRJE	3
1.1	TE PERGJITHSHME.....	3
1.2	PROCESI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS	3
1.3	KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS TË NJË PROJEKTI	4
2	PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	5
2.1.	KUADRI LIGJOR KOMBETAR.....	5
2.2.	PERMBLEDHJE E KUADRIT LIGJOR	6
2.3.	METODOLOGJIA E VLERESIMIT.....	8
3	PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT	9
3.1	TE PERGJITHSHME.....	9
3.4	NJESIA ADMINISTRATIVE MARGEGAJ.....	10
3.5	GJEOGRAFIA.....	11
3.6	RELIEVI	11
3.7	KLIMA.....	11
3.8	FLORA DHE FAUNA	11
3.9	PARKU KOMBETAR "LUGINA E VALBONES.....	12
3.10	MJEDISI FIZIK	12
3.11	MJEDISI BIOLOGJIK.....	13
3.12	MONUMENTET E NATYRES QE I PERKASIN RRETHIT TE TROPOJES.....	14
3.13	ZONAT E MBROJTURA DHE MONUMENTET E NATYRËS	15
4	PERSHKRIMI I AKTIVITETIT	18
4.1	TE PERGJITHSHME.....	18
4.2	VENDODHJA E AKTIVITETIT	18
4.3	LIDHJA E OBJEKTIT ME INFRASTRUKTUREN INXHINIERIKE	20
4.4	INFORMACION PËR SHKARKIMET NË MJEDIS.	21
5	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS TE AKTIVITETIT	22
5.1.	TE PERGJITHSHME.....	22
5.2.	VLERESIM I IMPAKTEVE KRYESORE NE MJEDIS	22
5.3.	NDIKIMET E PRITSHME NE MJEDIS.....	23
6	PLANI I MASAVE ZBUTËSE TË NDIKIMEVE NË FAZËN E NDËRTIMIT TË RESORTIT	26
7	PROGRAMI MONITORIMIT	29
8	REKOMANDIME	30

1 HYRJE

1.1 Te pergjithshme

Qellimi i ketij projekti eshte ndertimi dhe funksionimi i nje impiant prodhim betoni nga Subjekti GARDEN LINE shpk . Aktiviteti do te zhvillohet prane Fshatit Shoshan , Njesia Administrative Margegaj, Bashkia Tropoje, Qarku Kukes.

Impianti i prodhimit te betonit do te ndertohej per ti ardhur ne ndihme ndertimit te veprave te HEC Dragobise..

Ky impiant do te ndertohej per nje kohe e cila lidhet me perfundimin e punimeve civile te ndertimit te Hec-it

Dhe ne ne vije te pergjithshme ky impiant prodhim betoni do te jete provizor pasi do te funksionojte per aq kohe sa te zgjasin punimet per ndertimin e veprave inxhinjerike te HEC-it.

Nenshkrimi i nje sere konventash dhe miratimi i kuadrit ligjor per mjedisin ne funksion te tyre, detyron institucionet shteterore dhe subjektet fizike e juridike ti nenshtrohen disa procedurave vleresimi te impaktit te tyre para ndertimit dhe venies ne funksion te aktivitetit.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) eshte nje prej instrumentave parandalues dhe minimizues te ndikimit mjedisor dhe per projektin specifik, hartohet duke u bazuar ne kerkesat e zhvillimit te aktivitetit nga subjekti “GARDEN LINE” Sh.p.k.

Ky raport perfshin vleresimin, identifikimin, si dhe percaktimin e masave zbutese te ndikimit ne mjedis te aktivitetit te impiantit te prodhimit te betonit.

1.2 Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e zhvillimit te aktivitetit. Në procesin studimor të VNM përdoret informacioni dhe të dhënat teknike ekzistuese.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis hartohet qe ne fazen e projektidese per zhvillimin e aktivitetit, por gjithsesi, edhe per aktivite ekzistuese te cilat jane objekt i nje leje mjedisore ose i ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Sipas kushtetutes se Republikes se Shqiperise, shteti siguron me te gjitha mjetet dhe mundesite qe ka, nje mjedis te paster dhe te sigurte per qytetaret dhe brezat e ardhshem.

1.3 Kërkesat e përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti

1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.

2. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.

3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

4. Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e vlerëimit të ndikimit në mjedis përfshin:

a) procesin paraprak të vlerëimit të ndikimit në mjedis;

b) procesin e thelluar të vlerëimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerëimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;

b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

2 PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

2.1. Kuadri ligjor kombetar

Sa me siper, ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte mbështetur ne legjislacionin mjedisor si me poshte dhe ka per qellim qe te identifikojë, parashikojë dhe parandalojë ndikimin e këtij aktiviteti ne mjedis.

Kuadri ligjor për VNM-ne sigurohet ne menyre te drejtperdrejte nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri Ligji Per mbrojtjen e mjedisit dhe Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Keto ligje se fundmi jane perafruar plotesisht me ligjet e Bashkimit European per mbrojtjen e mjedisit dhe Vlersimin e Ndikimit ne Mjedis.

Bazuar ne Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 Per lejet e mjedisit, ne Aneksin Nr.1 ,ky projekt eshte i perfshire ne listen e aktiviteteve qe duhet te paisen me leje mjedisore, sipas percaktimeve te ketij ligji, per te gjitha instalimet klasifikohet si aktivitet per tu paisur me leje tipi B. (Pika 3.1 e, e shtojces per lejet).

Sipas Ligjit Nr.10 440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për proceduren e VNM-se”, ky projekt nuk perfshihet as ne shtojcen 1 dhe as ne shtojcen 2 te ketij ligji dhe si rrjedhoje nuk eshte i detyruar ti nenshtrohet procedures se miratimit te VNM paraprake ose te thelluar.

Me tej per te aplikuar per paisje me leje mjedisore tipi B, kerkohet konsultimi me publikun, per te cilin lind nevoja e hartimit te nje raporti VNM-je te permblodhur, per tu publikuar ne faqen zyrtare te AKM-se, DRM-se perkatese dhe Njesise se Qeverisjes Vendore, ne perputhje kjo me kerkesat e VKM Nr. 419, date 25.06.2014.

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

VNM e permblodhur. Ky vlen per projekte qe mund te kene impakte potenciale me te vegjel ne permasa qe serish kerkojne nje vleresim profesional te impakteve te tyre. Keto perfshijne projekte qe jane listuar ne Shojcen 2 te Ligjit per VNM dhe ndryshime apo rehabilitime te projekteve te listuar ne Shtojcen 1 dhe qe nuk klasifikohen ndryshe nga AKM.

VNM i Thelluar. Ky vlen per projekte me impakte potencialisht te konsiderueshme, siç figurojne ne listen e Shojces 1 te Ligjit, ato projekte te listuara ne Shtojcen 2 per te cilet Agjencia Kombetare e Mjedisit mendon se do te kene nje impakt te konsiderueshem mbi mjedisin (bazuar ne informacionin e siguruar nga propozuesi ne kohen e aplikimit)

dhe veprimtarite qe jane per tu implementuar ne zonat e mbrojtura apo zona bregdetare te Republikes se Shqiperise.

Aktiviteti ne vleresim, ne baze te klasifikimit te tij si leje e tipit B, mund ti nenshtrohet raportit te permblodhur te VNM-se pavaresisht formularit te shtojces nr. 2 te VKM Nr. 419, date 25.06.2014 Per lejet e mjedisit.

Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te veçante dhe te rëndesishem te mjedisit. Keshtu, nder me specifiket mund te permendim:

Ne ligjin Nr. 10 431, date 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” theksohet ne kapitullin V (VNM) neni 25 se:

Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

2.2. Permbledhje e kuadrit ligjor

Gjate dhjetevjeçarit te fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore, si rezultat i ndryshimeve degraduese mjedisore te cilat kane ardhur si rezultat i industrise para viteve 90-te dhe zhvillimeve te fundit ne fushen e ndertimit dhe industrise. Menaxhimi dhe mbrotja e mjedisit jane pjese e Legjislacionit Shqiptar, Neni 59(d) shkruhet se: “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve qe disponon, si dhe ne plotesimin e nismes dhe te pergjegjesise private, synon:

Neni d): nje mjedis te shendetshem dhe ekologjikisht te pershtatshem per brezat e sotem dhe te ardhshem.

Sipas Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”, Ministria e Mjedisit eshte autoriteti pergjegjes per rishikimin e dokumentit VNM te pergatitur nga ekspertet e licensuar prej ministrise se mjedisit.

Pervec Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”, Parlamenti i Republikes se Shqiperise miratori edhe Ligjin Nr. 10440 Date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”. Ky ligj eshte zhvilluar dhe bazuar ne Direktivat e EU dhe praktikat nderkombetare te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis. Përgatitja e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të aktivitetit të propozuar është kryer duke u bazuar në aktet ligjorë të mëposhtëm:

- Ligj nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Neni 25, i cili përcakton kërkesën për vlerësimin e ndikimit në mjedis, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit;
- Ligj nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i cili përcakton dhe specifikon kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis, projektet që i nënshtrohen, përgjegjësitë e palëve në proces;
- Ligj nr.9587 datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i cili kërkon ruajtjen dhe mbrojtjen e specieve biologjike dhe mbrojtjen e vlerave biologjike ku përfshihen edhe ekosistemet dhe habitatet. Ligji kërkon që veprimtaritë ose përdorimet e reja në ekosisteme, habitate dhe peizazhe të mbrojtura ose jo të mbrojtura mund të ushtrohen vetëm pasi t'u jenë nënshtruar procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të jenë pajisur me leje mjedisore;
- Ligj nr.8906 datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”, qëllimi i të cilit është të sigurojë mbrojtje të veçantë të përbërësve të rëndësishëm të rezervave natyrore, të biodiversitetit dhe të natyrës, në tërësi, nëpërmjet krijimit të zonave të mbrojtura. Zonat e mbrojtura krijohen për të siguruar ruajtjen dhe ripërtëritjen e habitateve natyrore, të llojeve, të rezervave dhe të peizazheve natyrore. Zhvilluesit e projekteve dhe veprimtarive duhet të zbatojnë projektet e tyre në përputhje me statusin e mbrojtjes

së zonave të mbrojtura (duhet të evidentohet prania ose jo e tyre në zonën e projektit dhe masat që duhen marrë);

- Ligj nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i cili ka për qëllim të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut si dhe të sigurojë administrimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet menaxhimit të integruar të tyre;
- Ligj Nr. 10119 date 23.04.2009 “Per planifikimin e territorit”
- Ligj nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i cili përcakton kërkesat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma, mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma;
- Ligj nr.8897 datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i cili sanksionon që personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, vendas ose të huaj, kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e ajrit, ta mbrojnë atë nga ndotjet e shkaktuara nga veprimtaria që ushtrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Vendim Nr.1189, Datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të Mjedisit”
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”
- Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis”.
- Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”.
- Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- Vendim nr.99 datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” në të cilin kategorizohen tipet e mbetjeve dhe kriteret për klasifikimin e tyre;
- VKM nr.247 datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”;
- VKM nr.229 datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”;
- Vendim Nr. 686, date 29.07.2015, “Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive dhe afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit te Mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit te deklarates mjedisore.”
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr.8 datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.

2.3. Metodologjia e Vleresimit

3. Per hartimin e raportit te VNM, porositesi vuri ne dispozicion te hartuesve te raportit materialin teknik dhe juridik. Ky raport vleresimi pergatitet me kerkese te investitorit. U kryen inspektime ne terren per te konstatuar vendodhjen, karakteristikat territoriale te kesaj zone, gjendja e faktoreve te mjedisit, si dhe per te terhequr mendimin e komunitetit te zones dhe zhvillimin e aktivitetit.

4. Procedura e miratimit mjedisor të projektit

Kategoria sipas Legjislacionit Shqiptar

Procedura qe Duhet Ndjekur (Duke plotesuar Standartet Shqiptare)

Aneksi i Ligjit 10440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” (Lista e veprimtarive te cilat duhet ti nenshtrohen procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis)

Bazuar në dispozitat e Ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, veprimtaria e propozuar nuk duhet t’i nënshtrohet procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Aneksi i Ligjit 1044, date 14.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” (Lista e veprimtarive te cilat duhet ti nenshtrohen procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis)

Bazuar në dispozitat e Ligjit nr.10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, **veprimtaria e propozuar duhet te pajiset me leje Mjedisore sipas shtijce I Pika 3.1/e**

Subjekti para aplikimit ne QKL per leje mjedisore duhet te realizoje proceduren e konsultimit me mjedisin.

Mbasi të jetë realizuar procedura e konsultimit me mjedisin, subjekti do aplikojë pranë Qendres Kombetare te Licensimit per Leje Mjedisore, e cila e përcjell për shqyrtim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Në varësi të projektit AKM mund të shprehet me *Leje Mjedisore te Tipit B*.

3 PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT

3.1 Te pergjithshme

Zona Gjeografike: Tropoja kufizohet në veri me Republikën e Kosovës dhe të Malit të Zi, në perëndim me Bashkinë Shkodër, në jug me bashkitë Vau i Dejës dhe Fushë-Arrëz dhe në jug-lindje me Bashkinë Has. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Bajram Currit.



Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re ka një popullsi prej 20,517 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 28,216 banorë. Ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 1057.3 km² me një densitet prej 26.68 banorë/km² sipas të dhënave të Regjistrimit Civil dhe 19.40 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Kjo bashki përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Bajram Curri, Fierza, Lekbibaj, **Margegaj**, Llugaj, Bujan, Bytyçi dhe Tropojë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Tropojës dhe qarkut të Kukësit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Bajram Curri dhe Fierza) dhe 68 fshatra.

Tropoja zotëron pasuri të shumta natyrore, por mungesa e investimeve dhe e perspektivës së zhvillimit ka detyruar një pjesë të konsiderueshme të banorëve të kryejnë migrim të brendshëm dhe të jashtëm. Mesatarja e rënies së popullsisë në shkallë rrethi është 26.60 %.

Tropoja është një zonë kryesisht bujqësore dhe blegtorale. Sektorët prioritarë me bazë zhvillimi për të ardhmen konsiderohen turizmi rural dhe malor, prodhimi bujqësor dhe përpunimi i produkteve bujqësore, duke u mbështetur në kushtet e përshtatshme natyrore, klimatike dhe gjeografike të rrethit. Ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë konsiderohet industria nxjerrëse e minierave.

Një rol të rëndësishëm luan sektori i blegtorisë, pasi zona ka shumëllojshmëri të kullotave natyrore. Hapësira e gjerë e kullotave alpine ofron një kapacitet të mjaftueshëm për zhvillimin e blegtorisë.

Prodhimet blegtorale përdoren për konsum familjar dhe një pjesë e tyre shiten në tregun e brendshëm. Megjithatë, mungesa e baxhove dhe e tregjeve për produktet si mishi, qumështi, gjalpi, djathi dhe leshi i bagëtive e kanë demotivuar këtë sektor.

Tropoja ka kushte të favorshme edhe për zhvillimin e bletarisë. Por pavarësisht nga cilësia e mjaltit, ai karakterizohet nga një rendiment relativisht i ulët, rreth 9 kg/zgjuar. Në përdorim më të lartë rezulton mjalti i Zogajve (Bytyç) dhe mjalti i gështenjës (kryesisht në zonën e Krasniqes), i cili rekomandohet për vetitë e tij kurative.

Industria minerare është përqendruar në një numër të vogël kompanish, në krahasim me potencialin e madh mineral të Tropojës. Mineralet kryesore që ndeshen në rrethin e Tropojës janë kromi (3 milion ton të pa shfrytëzuar), kuarci (300 mijë tonë të pa shfrytëzuar), boksitet (3 milion ton të pa shfrytëzuar), olivinitet (50 milion ton të pa shfrytëzuar).

Turizmi është sektori me perspektivën më premtuese për të ardhmen e Tropojës. Turizmi malor është nën sektori kryesor, i cili është i zhvilluar kryesisht në Luginën e Valbonës, por edhe në shumë atraksione të tjera të pashfrytëzuara. Rrethi i Tropojës karakterizohet nga etnografia, folklori, historia dhe gastronomia e pasur. Përgjatë gjithë luginës Valbonës janë ndërtuar rreth 24 hotele dhe shtëpi pritëse në shërbim të turistëve vendas dhe atyre të huaj.

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe zgjerimi i potencialeve turistike konsiderohen sfidat kryesore për kryebashkiakun e ri të Tropojës. Përveç mungesës së rrugëve lidhëse midis zonave, qyteti i Bajram Currit mbart një sërë problemesh të pazgjidhura me infrastrukturën dhe ujin e pijshëm.

Sistemimi i tregut ushqimor dhe atij të mishit është një ndër problemet që has qyteti i Bajram Currit prej dekadash. Ka 23 vjet që premtohet ndërtimi i një thertoreje, por sot e kësaj dite, mishi tregtohet te Përroi i Shydenicës, në ish-thertoren e grumbullimit.

Administrimi i mbetjeve është një tjetër element kyç në sfidat e reja që do të hasë kryetari i bashkisë. Aktualisht mbetjet grumbullohen në Koj, ku digjen duke dëmtuar rëndë ambientin dhe ndotur mjedisin përreth.

Ndërtimi i pikave të grumbullimit dhe shpërndarjes së gështenjave dhe arrorëve duhet të jetë një tjetër element i rëndësishëm për të zhvilluar bujqësinë dhe ekonominë në këtë zonë.

Ndërkohë që zonave të thella malore u duhet ofruar shërbimi shëndetësor, pasi ato nuk mund të presin vetëm çfarë ofron spitali i qytetit dhe në rastin më të shpeshtë ai i Gjakovës.

Turizmi është një tjetër armë e fortë për zhvillimin e Tropojës, e cila kërkon një strategji të qartë dhe mbështetje të iniciativave private.

3.4 Njesia Administrative Margegaj

Njesia Administrative Margegaj shritihet në veriperëndim të rrethit të Tropojës. Në veri kufizohet me Republikën e Malit të Zi, në jug me Njesinë Administrative Bujan e qytetin e Bajram Currit, në perëndim me rrethin e Shkodrës dhe në lindje me komunat Tropojë e Llugaj. Emri Margegaj vjen nga emri i një fisi që banonte në këtë fshat pra Mark Gega.

Në këtë njesi ndodhet një vendbanim i hershëm në fshatin Shoshan që quhet Gryka e Qytetit. Në këtë fshat janë rrënojat e një qyteze ilire. Tipi i vendbanimit është gjatësor përgjatë luginës. Distanca midis shtëpive është 100m. Shtëpitë janë të ndërtuara me gurë dhe me tullë. Shtëpitë janë dy katëshe të tipit kullë, por më vonë është i adoptuar me ndërtime moderne. Në paisjet e brendshme alternohen tradita orientale me moderne europiane. Shtëpitë janë të rrethuara me mure dhe me gardh, por kanë edhe kopësht. Distanca nga kufiri me Kosovën është 10 km, kurse me Malin e Zi është zonë kufitare. Rruga kombëtare kalon mes për mes komunës duke përbërë një element pozitiv për zhvillimin e kësaj komune.

3.5 Gjeografia

Njesia Administrative Margegaj shtrihet në veriperëndim të rrethit të Tropojës. Ajo ka një sipërfaqe 269.4 km². Në veri kufizohet me Republikën e Malit të Zi, në jug me Njesinë Administrative Bujan e qytetin e Bajram Currit, në perëndim me rrethin e Shkodrës dhe në lindje me komunat Tropojë Fshat e Llugaj. Emri Margegaj vjen nga emri i një fisi që banonte në këtë fshat pra Mark Gega.

3.6 Relievi

Relievi paraqet 2 pamje të ndryshme.

Zona malore paraqitet me maja që lartësohen në formë kullash deri në 2698 m lartësi (Jezerca) shumë të thepisura shpesh me pamje fasadash që bien pingul mbi luginën e Valbonës, por të veshura me drurë e me cirqe të luginave me borë të përjetshme.

Zona fushore paraqet pamjen e tarracave lumore dhe zbret deri në 250 m. Në këto tarraca ndodhen fshatrat Shoshan, Koçanaj, Paqe dhe Fushë-Lumë.

3.7 Klima

Në këto zone mbizoteron klima mesdhetare paramalore dhe malore. Reshjet bien kryesisht në stinën e vjeshtës. Ka reshje dëbore trashësia e së cilës shkon nga 50 deri në 150 cm. Periudha me reshje bore zgjat nga dhjetori deri në muajin shkurt. Orteqeve janë të rrallë dhe shkaktojnë dëme si bllokim rrugësh, ndërprerje të energjisë elektrike etj. Breshëri bie në stinën e verës. Ngricat janë një fenomen i njohur dhe shfaqen në dhjetor deri në fund të marsit. Për nga burimet hidrike kjo zonë është e pasur dhe përshkohet nga lumi i Valbonës dhe degët e saj. Pasuri hidrografike konsiderohet burimi i Shoshanit (burimi ujor më i madh në ballkan).

3.8 Flora dhe fauna

Tokat janë të kafejta, të hijta kafe, të murrme pyjore dhe livadhore malore. Për sa i përket florës dhe faunës është mjaft e larmishme. Diferencimet e mëdha mbi nivelin e detit në mes të zonës fushore e cila është (300m) dhe asaj malore (mbi 2000m), majave shumë të larta dhe luginave të thella, ekspozimit të shpatëve ndaj rrezatimit diellor, përbërjes gëlqerore të shkëmbinjve, burimeve të shumta ujore dhe mikroklimave që krijohen, krijojnë kushte ideale për shumëllojshmërinë e biodiversitetit. Në zonën fushore kultivohen mollët, kumbullat, qershitë, pjeshkët, arrat, rrushi etj. Në brezin e dushqeve mbretëron gështenja e cila është më e madhja në ballkan, që nis nga Fierza kalon nëpër Komunën Margegaj dhe vijon deri në Pejë të Kosovës. Blirët gërshetohen me frashërat, panjat dhe lajthitë. Në qafmale gjendet

mështekna, retuza, e cila është karakteristike për zonën e tundrës. Sipërfaqen më të madhe e zë druri i ahut. Lartësitë e zënë pishat si ajo e butë dhe e zezë, bredhi i bardhë dhe i zi. Kullotat alpine të zënë bimët e familjes gramore ku lulet formojnë qylyma të vërtetë shumëgjyrësh. Fauna është mjaft e larmishme, në përshtatje me ambientin e bimësise. Majat e xhveshura e kullotat alpine të popullon dhia e egër, atë të pishave dhe të ahut të popullon riqerbulli, ariu, macja e eger, ujku, dhelpra, lepuri, nusja e lalës, derri i egër etj. Në atë të dushqeve gjendet shqarhi, baldosa, ketri. Nga shpendët ndeshen gjeli i egër, sokolët e bjeshkëve, çukapikët laramanë, dallëndyshet, shqiponjat etj. Lumenjtë të popullojnë lundërza dhe katër llojet e troftave.

3.9 Parku Kombëtar “Lugina e Valbones

Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 102, datë 15.01.1996, lugina e lumit të Valbones, me sipërfaqe 8000 ha, Shpallet “Park Kombëtar”, në administrim të DSHP, Tropoje.

3.10 Mjedisi Fizik

Pozicioni gjeografik. Konsiderohet mrekullia shqiptare e Alpeve. Ndodhet 25-30 km në veriperendim të qytetit Bajram Curri, qendra e rrethit të Tropojës. Kufizohet me parkun kombëtar të Thethit dhe zonën natyrore Strikte të Mbrojtur, Lumi i Gashit. Nga ana fiziko-Gjeografike, ndodhet në Krahinën Malore Veriore të vendit (KMV)

Territori i Parkut përshkohet nga rrugë automobilistike Bajram Curri-Dragobi-Valbone e Cerem. Shtrihet midis maleve të larta e të thepisura të mbuluara me një kolorit fantastik ngjyrash, në çdo stinë duke dhënë imazhin e një lugine plot labirinte e të papriturash. Ka vlera të larta shkencore e turistike, shoqërore e rekreative, të cilat ndërthuren me një biodiversitet me rëndësi kombëtare e ndërkombëtare. Majat e larta shkembore e imponuese, faqet e mbuluara me pyje, rrjedhjet e perrenjve e të lumit të Valbones, para nga sipër, krijojnë imazhin e një krateri gjigand e të perkryer në bukurit natyrore. Me të hyrë në kufirin lindor të Parkut, në afërsi të Shoshanit, shpallet një peisazh i rrallë bukurie. Kuriozitetin ia shton edhe Kaninoni i Shoshanit, disa metra i lartë. Në këtë vend lumi i Valbones ngushtohet se tepërmi dhe jep imazhin e prerjes së shkëmbit, si me thikë. Burimet e lumit të Valbones e kanë zanafillen në shpatet e malit të Jezercës. Maja më e lartë e Parkut dhe e Alpeve të Shqipërisë (2693.5 m), si dhe maja Briaset (2567.9 m). Lumi i Valbones është në mënyrë të medhënjtë e lumenjve të Alpeve, që derdhet në lumin Drin. Zbritja nga majat e maleve dhe nga Bjeshket e Ragamit e të Ceremit, është e rrembyeshme, plot zhurmë e shkumëzim, për vet përjetësi të terrenit. Lumi qetesohet në fshatin Valbone dhe vazhdon plotë gjallëri në drejtim të Dragobisë. Uji është i pastër, i kthjellët e mjaft i tejdukshëm deri në 1 m thellësi. Natyra e terrenit, nëpër të cilin kalon Valbona, është e larmishme dhe e përshtatshme për turizëm, lodhje e argetim, për ngjijtje alpinistike dhe sportet dimërore. Madhështia e këtyre maleve qëndron edhe në deboret e përjetshme, ndërsa në periudhën e verës krijohen ujvara magjepsese. Në brendësi të Parkut gjenden edhe mjaft guva e shpella, pak të njohura e të preferuara nga banorët. Në njërin prej tyre, në Shpellën e Dragobisë është strehuar udhëheqësi popullor i kësaj treve, Heroi i Popullit, Bajram Curri.

Vecori gjeologjike. Formacionet gjeologjike përbehen nga gelqerore, gelqerore - silicore, rreshpe argjilore, konglomerate, ndërsa në ultësira gjenden edhe depozitime aluvionale, flishe alevrolito - argjilo - ranore. Toka e parkut janë të Murrme Pyjore dhe Livadhore Malore. Në pjesë në zonën klimatike mesdhetare malore, në zona malore veriore. Është zona më e ftohtë e vendit, me dimër të gjatë e të ashpër.

Temperaturat mesatare vjetore te ajrit arrijne ne 7 - 10°C, ne vendet e larta deri ne 4 - 6°C. Periudha me e ftohte eshte ne dhjetor - shkurt. Ne disa raste, temperaturat zbresin dhe ne -10 deri - 20°C. Numri i diteve te akullta zgjat 70 - 100 dite.

Debora arrin lartesine 1.5 - 5 m dhe zgjat 60 - 160 dite. Vera konsiderohet mjaft e fresket; muajt me te nxehte jane korriku e gushti, me temperature 18 - 22°C. Lartesia mesatare e reshjeve vjetore shkon 2000 - 2500 mm (ne zona te vecanta edhe mbi 3000 mm).

3.11 Mjedisi biologjik

Flora. Lugina e Valbones konsiderohet e vetmja zone ku takohet me shumice formacioni pyjor me hormoq (Picea abies), nga 850 m mbi rrafshin e detit, ne fshatin Valbone, ne 1200 m, ne fshatin Ragam, kryesisht ne te majte te lumit Valbone. Pylli i hormoqit, ne luginen e Valbones, perben rastin unik te ketij lloji ne pyjet e Shqiperise, kombinuar edhe me peizazhin e bukur natyror te zones perreth. Ne kete pjese gjejne kushte te pershtatshme edhe ahu, robulli, arneni, hartina, geshtenja, arra, molla etj. Nder shocierimet bimore me te rendesishme permenden: Mugheto - Pinetum leucodermis, pergjate perroit te ceremit, Fagus syl-vatica Piuns peace, etj.; hormoqi dhe ahu, vende vende, kane perhapje te njetratshme e te barabarte. Me Halle, ne keto shocierime, takohen edhe bredhi e plepi i eger. Nenpylli ka pak lloje. Me te shpeshta jane lajthia, frasheri i zi, shkoza, thana, shtogu i kuq, etj. Ne katin bimor, vlere te madhe ka shocierimi me boronice, euforbie, luleshtrydhe; po ashtu, takohen dioskarea e ballkan-it, hollokuqi i shkurter, xherrokulli, shtarea, shmanga shqiptare, barpeshku i Nikolait, etj.

Fauna, Ka karakter te theksuar alpin. Gjitarat me te permendur e qe takohen me dendur jane: ariu i murrem, ujku, macja e eger, lutra, qelbesi, zardafi gushverdhe; ne majat e thepisura te maleve per-reth e ne kullota gjen kope me dhi te egra (deri 100 krere), te cilat i japin Parkut gjalleri te vecante. Ne territorin e Parkut Kombetar jane dhe gjeli e pule e eger, shqiponja bishtvizuar, qukapiket, si dhe nje numer i konsiderueshem zogjsh kengetare stinore. Nga amfibet e reptilet, takohen e bukura e dheut, tritoni i alpeve, bretkoca barkverdhe, ajo e drureve, e perrenjve, e kuqeremta e pyllit; thithlopa, hardhuca me luspa, kakzoga, shigjeta e gjate, neperka etj. Lumi i Valbons eshte i pasur me troften e mermerte. **Hormoqi** (Picea excelsa) Eshte dru me permasa te medha, qe arrin deri 50 m lartesi e 2 m diameter; jeton mbi 500 vjet. Ka perhapje te kufizuar ne vendin tone, kryesisht ne Luginen e Valbones, ne lartesi 1200 — 1600 mbi rrafshin e detit. Eshte lioj i rrezikuar per zhdukje; kerkon perkujdesje per t'u zhvilluar. Peizazhet me hormoq jane te vleresuara ne mjedisin ku jetojne.

Pjesemarrja e popullsise lokale ne menaxhim Fshati Valbone eshte pika me e rendesishme turistike, ku jane ndertuar edhe disa qendra pushimi. Ne kete pike verehen burime te shumta me uje te paster, te kulluar e teper te ftohte. Ceremi eshte nder fshatrat me malore te vendit. Ndodhet midis pyjeve e kullotave natyrore, te nje bukurie te vecante, i pershtatshem per zhvillimin e turizmit malor-alpin. Ne afersi te Kukajt gjenden burime ujore fantastike. Pak me siper, lumi i Valbones takohet me perroit e Kukajt. Fshati-

Rregebulli (Lynx lynx I) Eshte kafsha me e bukur, me e eger dhe me e vecante e vendit tone. Zakonisht e therresin edhe tigri i Evropes. Ka pamjen e maces se madhe. Gjatesia e trupit shkon 80 —130 cm, bishti i shkurter, rreth 13 cm i gjate. Peshon deri 30 kg. Eshte jashtezakonisht i shkathet. Ushqehet me gjakun e fresket . to kafsheve e shendeve to eger. Armiku me i madh eshte ujkut dhe macja e eger. Pjell nje here ne vit, deri dy kelyshe, to cilet me shume jane meshkuj, gje qe ndikon ne zhvillimin e tij.

Ragam eshte me ne thellesi te lugines, ne terren mjaft te ashper, te thepisur, qe gershetohet me kullotat subalpine. Piktoreske hapet pamja rreth fshatit Dragobi, ku pyjet dhe burimet ujore, gershetohet me livadhet, shtepite karakteristike te treves dhe tokat bujqesore. Lugina e Valbones ka natyre te bukur e te paster. Konfiguracioni, morfologjia, hidrologjia, pyjet, kullotat, llojshmeria e luleve, kullotja e bagetive, shtepite karakteristike, bujaria dhe mikpritja e banoreve, krijojne kushte per zhvillimin e turizmit fitimprures.

Mendime per te ardhmen

Ekziston vetem nje plan mbareshtimi per pyjet dhe disa stu-dime to pjesshme per kete territor. Ne to ardhmen, per vete rendesine dhe statusin ge ka, nevojitet nje plan konservimi e menaxhimi, ne perputhje me vlerat dhe kategorite menaxhuese to Lugines se Valbones. Lugina e Valbones, se bashku me Parkun e Thethit dhe Lumin e Gashit, duhet te jene pjese e “Parkut te Paqes”. Ky Park do te kete nje plan zhvillimi “Nderballkanik” te ketij rajoni. Turizmi familjare paraqet rendesi te vecante dhe duhet nxitur. Nevojitet gjithashtu, mbeshtetja e donatoreve per ndertime, nga popullsia vendase, qe te krijohen mjedise me te pershtatshme banimi dhe pushimi.

3.12 Monumentet e natyres qe i perkasin rrethit te Tropojes

Gjeomonumentet

1.*Shpella e Haxhise*. Ndodhet ne majen e Thate, afer fshatit Valbone, Njesia Administrative Margegaj, 1630 m mbi nivelin e detit. Eshte formuar nga karsti pergjatekyqezimit te thyerjeve tektonike ne gelqeroret e triasit-jurasit. Njihet hyrja 2-3 m dhe gjatesia rreth 120 m. Ka vlera shkencore, gjeomorfologjike, didaktike. Vizitohet sipas rruges Bajram Curri-Valbone.

2.*Shpella e Akullit*. Ndodhet prane fshatit Valbone, Njesia Administrative Margegaj, 2230 m mbi nivelin e detit. Eshte formuar nga proceset glacio-karstike ne kyqezimin e thyerjeve tektonike ne gelqeroret e trias-jurasit. Gjatesia e eksploruar eshte mbi 250 m, gjeresia 50 m, lartesia 10-15 m. Ka konkrecione dhe akull fosil, ndoshta te kuaternarit, vlera shkencore, gjeomorfologjike, didaktike, turistike. Vizitohet sipas rruges rurale Bajram Curri-Valbone.

3.*Rrasa Pecmarres*. Ndodhet ne veriperendim te majes Grykat afer fshatit Valbone, Njesia Administrative Margegaj, 1990 m mbi nivelin e detit. Eshte nje greminde gelqerore e pakalueshme, e gjate 700-900 m, e gjere 200-500 m, e larte 700-800 m. Ka vlera shkencore, gjeomorfologjike, didaktike, turistike. Vizitohet sipas rruges Bajram Curri-Valbone.

Hidromonumentet

1.*Burimi i Qukut te Dunishes*. Ndodhet afer fshatit Valbone, 870 m mbi nivelin e detit. Burim karstik rreze greminde shkembore te Rrases se Pecmares, me prurje mbi 1000l/sek, uje te paster e mjedis terheqes, vlera shkencore, hidrologjike, didaktike, turistike. Vizitohen sipas rruges rurale bjam Curri-Valbone.

2.*Burimet e Vlabones*. Ndodhen prane fshatit Valbone, Njesia Administrative Margegaj 932 m mbi nivelin e detit. Burim karstik ne kontaktin gelqerore –rreshpe, me prurje mbi 1000l/sek, uje te paster, te ftohte, e mjedis terheqes perreth. Ka vlera shkencore, hidrologjike, ekonomike, turistike. Vizitohen sipas rruges rurale bjam Curri-Valbone-Rragam.

Biomonumentet

1.*Shelgu i rrytezuar*. Ndodhet ne Malin Gryket e Hapura afer fshatit Valbone, Njesia Administrative Margegaj, 2200 m mbi nivelin e detit. Perben arealin e bimes relikte te akullzimit kuaternar, me permasa

100-1200 m gjatesi, gjeresi 400-500 m dhe vlera shkencore, biologjike, didaktike. Vizitohet sipas rruges Bajram Curri-Valbone dhe kembesore ne Gryket e Hapura.

3.13 Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës

Zonat e mbrojtura bashkë me monumentet e natyrës përfaqësojnë një rrjet sipërfaqesh që mbrohen në shkallë të caktuar, sipas përcaktimeve kategorike të tyre, për shkak të vlerave natyrore kombëtare, por edhe rajonale e globale.

Zona në të cilën propozohet të zbatohet projekti për nderitim e Godines 4 kate + papafingo, me funksion banimi bie ne zone te mbrojtur (Park Kombetar) “Lugina e valbones”. Kjo eshte nje zone e banuar, subjekti per ndertimin e kesaj godine do prishi godinen ekzistuese e cila nuk eshte ne gjendje te mire funksionale. Prane zones se ndertimit te godines jane evidentur dy monumente natyre te cilat nuk ndërpritën nga objekti qe do ndertohet.

Njeri nga monumentet ndodhet ne perendim te prones ne nje distace ajrore pre 1.524,5 m , me kordinata sipas sistemit Gaus Kruger: X. 44 07 962 dhe Y. 47 02 403

Dhe monumenti tjetër i natyrës ndodhet ne anen lindore te prones ne nje distave ne vij ajrore prej 2.664,3 m me koordinata sipas sistemit Gaus Kruger: X. 44 09 118 dhe Y. 47 02 577

Harta e monumenteve të natyrës në zonën e projektit



Territori ne studim ben pjese ne zonen e mbrojtur te “Lugines e Valbones” (Park Kombetar), ku zbatohet shkalla e dyte e mbrojtjes.

1. Rezerve strikte natyrore\ rezervat shkencor\ (kategoria I);
- 2. Park kombetar (Kategoria II);**
3. Monument natyror (Kategoria III);
4. Rezervat natyror i menaxhuar\ zone e menaxhimit te habitateve dhe llojeve (Kategoria(IV);
5. Peizazh i mbrojtur (Kategoria V);
6. Zone e mbrojtur e burimeve te menaxhuara\ zone e mbrojtur me perdorim te shumefishte (Kat VI).

Territori ne studim ku do ndertohet “Impjanti I betonit” eshte e perfshire ne Parkun Kombetare te “Lugines se Valbones”.



Në parkun kombëtar zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, ku janë të ndaluara:

- a) shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës;
- b) neutralizimi i mbetjeve me origjinë jashtë territorit të parkut kombëtar;
- c) shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase, kur ato sjellin ndryshime në biodiversitetin e zonës;
- ç) riprodhimi intensiv i kafshëve të gjahut, me përjashtim të riprodhimeve shpëtuese;
- d) ndërtimi i rrugëve, autostradave, hekurudhave, zonave urbane, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të gjatë;
- dh) larja dhe spërkatja e rrugëve me kimikate;
- e) mbjellja e pyjeve monokulturë;
- ë) ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara;

- f) lëvizja e mjeteve të transportit jashtë rrugëve të caktuara;
- g) gjuetia me ushqime të helmuara;
- gj) nxjerrja e mineraleve, gurëve, torfave me përjashtim të gurëve dhe rërës për mirëmbajtjen e parkut;
- h) veprimtari masive sportive, turistike, jashtë pikave të caktuara;
- i) organizimi i garave me automjete e motoçikleta.

Në këtë zonë mund të ushtrohen, por vetëm pasi të pajisen me leje mjedisi, veprimtaritë që synojnë:

- a) ndryshimin e gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;
- b) ngritjen dhe funksionimin e objekteve për qëllime ushtarake dhe mbrojtjeje;
- c) programe kërkimore-shkencore dhe monitoruese;
- ç) veprimtari kërkimore shkencore, arkeologjike, paleontologjike dhe për mbartjen e gjetjeve të tilla.
- d) përdorimi ose magazinimi i përkohshëm i agrokimikateve;

dh) veprimtari të tjera që nuk ndalohen shprehimisht nga pika 2 e këtij neni.

Pamje te Parkut Kombetar “Lugina e Valbones”



4 PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

4.1 Te pergjithshme

Qellimi i aktivitetit

Qellimi i aktivitetit eshte prodhimi i betonit te gatshem per ti ardhur ne ndihme punimeve civile te veprave te HEC Dragobise.

Ne kete raport vleresimi do te vleresojme vetem ndikimet e ndertimit dhe funksionimit te impiantit te prodhimit te betonit brenda kantierit te ndertimit.

Subjekti investitor

Shoqeria “GARDEN LINE” Sh.p.k me NIPT K11427004I,, me seli ne Tirane GARDEN LINE Marikaj eshte themeluar me date 06/12/2000 dhe ka si administrator Z. Klod Zigori. Aktiviteti i ketij subjekti sipas ekstraktit te QKR-se fusha e veprimtarise specifikohet:

Tregtim me shumice e pakice, import-eksport i bimeve dekorative dhe luleve, i makinerive dhe i pajisjeve te ndryshme per kopshtari.Projektimi dhe zbatimi i veprave dekorative ne lidhje me kopshtarine dhe kopshtaret, si dhe cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.Shoqeria ka per objekt zhvillimin e aktivitetit ekonomik ne fushen e kopshtarise dhe te inxhinierise se mjedisit. Aktivitetet ne fushen e realizimit te veprave te infrastruktures si rruge, sistemime perforcuese-mbajtese, germime etj.

4.2 Vendodhja e aktivitetit

Aktiviteti ne vleresim ndodhet ne fsahtin Shoshan, Njesia Administrative Margegaj, Bashkia Tropoje, Qarku Kukes.

Sheshi ne dispozicion te impjantit identifikohet sipas ortofotove dhe koordinatave te meposhtme sipas Sistemit Gaus Kruger:


Nr	X	Y
1.	4423679.95	4695666.67
2.	4423696.37	4695652.62
3.	4423739.61	4695667.78
4.	4423725.26	4695689.06

“IMPIANT PRODHIM BETONI”

Ortofoto e zones ne Vleresim



Harta Treguese



Te dhena teknike te aktivitetit

Shoqeria “GARDEN LINE” Sh.p.k me NIPT **K11427004I**, me seli ne Tirane Gardenline Marikaj, eshte themeluar me date 06/12/2000 dhe ka si administrator Z. Klod Zigori. Aktiviteti i ketij subjekti konsiston ne Tregtim me shumice e pakice, import-eksport i bimeve dekorative dhe luleve, i makinerive dhe i pajisjeve te ndryshme per kopshtari. Projektimi dhe zbatimi i veprave dekorative ne lidhje me kopshtarine dhe kopshtaret, si dhe cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Shoqeria ka per objekt zhvillimin e aktivitetit ekonomik ne fushen e kopshtarise dhe te inxhinierise se mjedisit. Aktivitetet ne fushen e realizimit te veprave te infrastruktures si rruges, sistemime perforcuese-mbajtese, germime etj


Subjekti, per zhvillimin e aktivitetit te tij do te ndertoje nje kantier per prodhimin e betonit. Betoni i cili do e prodhohet ne kete impjant do te perdoret per punimet inxhinjerike te ndertimit te HEC Dragobise

Kantieri ne dispozicion te ketij aktiviteti ka keto te dhena:

Kapaciteti prodhues i betonit, do te jete rreth

45-55 m³/ore.

Skema i Impjantit te Prodhimit te Betonit



4.3 Lidhja e objektit me infrastrukturen Inxhinierike

Kantieri, ne te cilin do te instalohet impianti i prodhimit te betonit nga subjekti “GARDEN LINE” sh.p.k e lidhja me infrastrukturen inxhinierike te zones eshte e ndertuar, pasi siperfaqja e aktivitetit ndodhet ne ane te rruges kryesore Tropoje-Valbone, ne krahun e djathte te saj prane fshatit Shoshan.

Foto te gjeneratoreve



Depozitat e ujit



Ujerat e gjeneruara nga funksionimi i ketij aktiviteti shkarkohen ne nje vaske dekantimi ne brendesi te siperfaqes se impiantit.

4.4 Informacion për shkarkimet në mjedis.

Shkarkimet ne mjedis gjate funksionimit te impiantit te prodhimit te betonit do te jene kryesisht pluhuri i lendes pare si granil dhe rere, zhurma e impiantit dhe ne rast te mundshem derdhje te cimentos ne sheshin e prodhimit. Procesi i prodhimit te betonit perfshine edhe perdorimin e ujit, si pjese e procesit teknologjik, kjo sherben per tretjen e cimentos dhe furnizimin e autobetoniereve me uje per procesin e lagjes se materialit te perzier, si dhe per larjen e cisternave te perzierjes se betonit.

Keto ujera do te jene me cemento dhe si rrjedhoje duhet te shkarkohen ne nje vaske dekantimi, jo ne mjedisin e zones. Per kete arsye, **subjekti ka bere te mundur ndertimin e nje grope dekantuese, por ne i sugjerojme qe subjekti ne kete grope te perdori material gjeotekstil i cili luan rolin e filtrit per te mos lejuar lendet e ngurta te depertojne ne thellesi te tokes, por lejon vetem kalimin e ujit te paster ne shtresat e poshtme te tokes.**

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njeran prej fazave kryesore; faza e funksionimit, pasi nuk perfshihen procese ndertimi ne kete kantier. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

5 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS TE AKTIVITETIT

5.1. Te pergjithshme

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njeran prej fazave kryesore; faza e funksionimit, pasi nuk perfshihen procese ndertimi ne kete kantier. Nuk marrim ne konsiderate fazen pas perfundimit te veprimtarise pasi ky aktivitet do te vazhdoje te jete i tille ne vazhdimesi. Ky aktivitet nuk prek zona me bimesi, ndodhet ne brendesi te sheshit te karrieres te miratuar per shfrytezim. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

5.2. Vleresim i impakteve kryesore ne mjedis

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi “Ndotësi paguan”
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe VKM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” dhe ka si synim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.:

Sa me sipër vlerësimi i ndikimeve në mjedis do të vlerësojë:

- Ndikimet në ajër
- Ndikimet në ujë
- Ndikimet në tokë
- Ndikimet në biodiversitet (mjedisi biologjik)
- Ndikimet në mjedisin social-ekonomik
- Ndikimet që shkaktojnë ndryshimet klimatike

5.3. Ndikimet e pritshme në mjedis

Ndikimet e mundshme gjatë fazës së funksionimit të aktivitetit mund të përmbledhen sipas elementeve të mjedisit, si më poshtë:

5.3.1. Ndikimet e mundshme negative në tokë

Instalimi i Impjantit të Prodhimit të Betonit	Ndotja e tokës si rezultat i rrjedhjeve të ndryshme gjatë ngarkimit dhe shkarkimit të automjeteve apo në rast të emergjencave të mundshme nga avarite në sistem. Sistemi i terminalit të shkarkimit është pjesërisht i shtruar me beton, si rrjedhojë mund të ketë ndotje të tokës, në raste të derdhjes së lëndës së cimentos në mjedis.
Lëvizja e automjeteve të transportit dhe përdorimi i makinerive në procesin e ndërtimit	Si pasojë e lëvizjes së makinerive: <ul style="list-style-type: none"> • do të kemi ngjeshje të tokës në sektorë të veçantë të saj, • mund të kemi rrjedhje aksidentale të lubrifikantëve nga ndonjë avari me pasojë ndotje të tokës.
Magazininim i lëndëve të para dhe parkim i automjeteve	Si rezultat i përshtatjes së sipërfaqeve të caktuara për parkimin e mjeteve të punës dhe magazinimin e lëndëve të

	para, <ul style="list-style-type: none"> • mund të ndodhë ngjeshje e tokës.
--	---

5.3.2. Ndikimet e mundshme negative në ujë

Instalimi i Impjantit te Prodhimit te Betonit	Shkarkimet ne ujera vijne nga: a) Pastrimi i ambientit ne rast te shkarkimit te cimentos se lengshme, kryesisht nga nderprerja e punes per shkak te difekteve te mundshme ne impjant. b) Ne rastet e pastrimit te automjeteve te transportit ne ambientin e kantierit, larja e autobetoniereve. c) Ujerat e lagies se sheshit te qarkullimit te automjeteve. d) Ujerat e perdorur per ambientet higjenosantare te ambientit te stafit
Lëvizja e automjeteve të transportit dhe përdorimi i makinerive në procesin e prodhimit te betonit	Si pasojë e qarkullimit të mjeteve dhe përdorimit të mekanikës mund të kemi rrrjedhje aksidentale të lubrifikantëve nga ndonjë avari e mundshme me pasojë ndotje të ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
Magaznim i lëndëve të para dhe parkim i automjeteve	Rrjedhje vajrash dhe lubrifikantësh nga automjetet e parkuar depozitim i mbetjeve nga materialet në trupat ujqorë të zonës

5.3.3. Ndikimet e mundshme negative në biodiversitet/pejsazh

Instalimi i Impjantit te Prodhimit te Betonit	Punimet per instalimin e impjantit te prodhimit te betonit do te shoqerohen me modifikim të pejsazhit ekzistues . Për të minimizuar këtë ndikim, i rekomandojme subjekti te mbjelle nje breze pemesh te larta per te minimizuar impaktin viziv.

5.3.4. Ndikimet e mundshme negative në ajër

Lëvizja e automjeteve të transportit dhe përdorimi i makinerive në procesin e ndërtimit	Si pasojë e lëvizjes së automjeteve do të gjenerohen: <ul style="list-style-type: none"> • zhurma, • pluhur, • gaze nga djegia e karburantit të motorëve.

Emetimet e zhurmave dhe gazeve të kamionëve në mjedis

Sa lidhet me emetimin e zhurmave gjatë fazës ndërtimore, duhet theksuar se ky ndikim është i përkohshëm. Së pari faza e instalimit është një fazë e mirëpërcaktuar në kohë dhe së dyti operacionet e ndërtimit do të kryhen brenda orareve të zakonshëm të punës.

Bazuar edhe në referencat ndërkombëtare për projekte të ngjashme vlerësohet se zhurmat teknologjike nga mjetet e rënda e japin efektin e tyre akumulativ deri në një rreze prej 150 - 200 m në varësi edhe të konfiguracionit natyror të terrenit i cili luan rolin e një barriere natyrale etj. Për rrjedhojë pritet që qendrat e banuara më të afërta të ndikohen negativisht nga zhurmat e pajisjeve të rënda si buldozerë, betoniere, kamionë etj.

Sipas natyrës së projektit të propozuar, mjetet më të përdorshëm në fazën e ndërtimit janë kamionët dhe betonieret, vlerat e emetimit të zhurmave të cilëve jepen në tabelën e mëposhtme.

Pajisja	Vlerat
Kamion	81 – 87 Leq dB (A) ne 15 m
Fadromë	76- 78 Leq (dB(A) ne 15 m

Ndërkohë Udhëzimi nr.8 datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”, përcakton vlerat e lejuara të zhurmës si në tabelën e mëposhtme.

Nivelet kufi të zhurmës në mjedis të caktuara

Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LA _{eq} (dBA)	Koha bazë (orë)	L _{max} Fast (dB)
Zona banimi				
Jashtë banese	Bezdi (shqetësim) serioze gjatë ditës dhe mbrëmjes	55	16	-
	Bezdi (shqetësim) i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	-
Në brendësi të banesave	Kuptueshmëri e bisedës dhe (bezdi) shqetësim i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	35	16	-
Në brendësi të dhomës së fjetjes	Prishja e gjumit natën	30	8	-
Jashtë dhomës së fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashtë)	45	8	-
Zona me aktivitetet social-ekonomik				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
Mjedisi urban				
Mjedise publike, të jashtme apo	Dëmtim dëgjimi	85	1	110

të brendshme				
--------------	--	--	--	--

Shpjegime:

LA_{eq} (dBA) = Niveli ekuivalent i matur në shkallën A

Koha baze (ore) = Koha gjatë së cilës bëhet matja

L_{Amax} Fast (dB) = Niveli i matur në shkallën A në mënyrën Fast (e shpejtë)

1 = Sa më e ulët që të jetë e mundur

2 = Presioni zanor maksimal (L_{Amax}, fast) matur 100 mm larg veshit

3 = Zonat e jashtme të qeta duhet të mbrohen dhe raporti i zhurmës hyrëse/shtesë me zhurmën e fonit natyral duhet të ruhet sa më i ulët që të jetë e mundur

4 = Nën kufjet e dëgjimit, përshtatur me vlerat e fushës së lirë

Nga krahasimi i nivelit të zhurmave që çlirojnë mjetet e punës me ato kufi të lejuara vërehet se nivelet e lejuara të zhurmave në qendrat e banuara më të afërta gjatë kohës së zbatimit të projektit mund të tejkalohen. Për këtë arsye, është e nevojshme që firma që do të zbatojë projektin të punojë me efikasitet për të mënjanuar orët e tejkujtura të punës dhe duke mënjanuar punimet në orët e para të mëngjesit ose në mbrëmje.

I njëjti arsyetim vlen edhe për sasinë e gazeve dhe pluhurave që do të emetohen si pasojë e djegies së karburantit në motorë dhe lëvizja e automjeteve.

6 Plani i masave zbutëse të ndikimeve në fazën e ndërtimit të resortit

TOKA		
Si pasojë e levizjes se shpesht te automjeteve do të kemi prishje të strukturës së tokës	Impjanti i prodhimit te betonit eshte ndertuar ne nje sipërfaqe e cila ka qene e lire nga objektet ekzistuese	Kompania zbatuese e projektit
Dëmtim i mundshëm i proceseve natyrore të drenazimit.	Gjatë stinës së thatë duhet të bëhet modelimi dhe ndërtimi i sistemit të drenazimit dhe kullimit të ujërave sipërfaqësorë dhe të reshjeve, për të evituar rrezikun e përmbytjeve gjatë stinës së lagësht. Kanalet e kullimit duhet të mbillen me bar anëve me qëllim që të pengohet procesi i gërryerjes së tyre gjatë transportit të ujërave sipërfaqësorë.	Kompania zbatuese e projektit
Si pasojë e punimeve të	Për të limituar sipërfaqen që do të ngjishet do të	Kompania zbatuese e

“IMPIANT PRODHIM BETONI”

ndërtimit dhe lëvizjes së makinerive do të kemi ngjeshje të tokës.	përcaktohen saktësisht vendet e qëndrimit të mjeteve të rënda dhe do të kontrollohet lëvizja e tyre për të mënjeluar qarkullimin e panevojshëm.	projektit
Ndotje e mundshme e tokës nga derdhja aksidentale e lëndëve ndotëse që përdoren gjatë nprodhimit apo nga karburantët dhe lubrifikantët e tjerë që përdorin automjetet e transportit dhe mjetet e rënda të punës.	Të gjitha automjetet dhe mjetet e punës që përdorin lubrifikantë të çdo lloji do t’i nënshtrohen kontrollove periodikë mbi gjendjen e tyre teknike. Të gjitha pjesët që mund të rezultojnë të dëmtuara dhe burim rrjedhjesh do të riparohen menjëherë. Në raste të rrjedhjeve aksidentale, do të bëhet pastrimi i menjëhershëm i vendit duke e larguar pjesën e ndotur të tokës (dherave), e cila do të depozitohet në fuçi të posaçme plastike ose metalike, me kapak, në pritje për trajtim të mëtejshëm.	Kompania zbatuese e projektit
Ujërat		
Modifikim i rrjedhave stinore sipërfaqësore të ujërave të shiut.	Nga studimet e deritanishme nuk janë vërejtur burime në sipërfaqen e zonës së kërkuar për zbatimin e projektit, megjithatë në varësi të lëvizjes dhe drejtimit natyror të ujrave sipërfaqësore do të rindërtohet sistemi sipas nevojave.	Kompania zbatuese e projektit
Si pasojë e qarkullimit të mjeteve dhe përdorimit të mekanikës mund të kemi rrrjedhje aksidentale të lubrifikantëve nga ndonjë avari me pasojë ndotje të ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.	Të gjitha automjetet dhe mjetet e punës që përdorin lubrifikantë të çdo lloji do t’i nënshtrohen kontrolleve periodikë mbi gjendjen e tyre teknike. Të gjitha pjesët që mund të rezultojnë të dëmtuara dhe burim rrjedhjesh do të riparohen menjëherë. Në raste të rrjedhjeve aksidentale, do të bëhet pastrimi i menjëhershëm i vendit duke e larguar pjesën e ndotur të tokës (dherave), për të mos lejuar depërtimin e ndotjes në ujërat sipërfaqësore dhe nivelin e ujit nëntokësor të zonës.	Kompania zbatuese e projektit
Depozitim i mbetjeve të tjera të ngurta të gjeneruara nga aktiviteti.	Në të gjithë sipërfaqen e kantierit do të vendosen kontenerë të posaçëm për mbetjet e ngurta. Depozitimi i mëtejshëm i tyre do të bëhet në vendet e caktuar që më parë në marrëveshje me pushtetin vendor.	Kompania zbatuese e projektit Organet e pushtetit vendor
Ajër		
Emetim pluhurash si	Lagje e zonave të kantierit ku kryhen këto lloj	Kompania zbatuese e

“IMPIANT PRODHIM BETONI”

pasojë e operacioneve të prodhimit të betonit dhe transportit.	operacionesh për të ulur sasinë e pluhurit. Mjetet e transportit do të pastrohen para daljes jashtë kantierit.	projektit
Emetim gazesh dhe aromash nga automjetet e transportit dhe mjetet e rënda të punës.	Planifikim i saktë i kohëzgjatjes së punimeve në terren për të mënjanuar tejzgjatjen e panevojshme të tyre. Të gjitha automjetet dhe mjetet e punës do t’i nënshtrohen kontrolleve periodikë në lidhje me gjendjen teknike të tyre. Njëkohësisht rëndësi do i kushtohet cilësisë së lëndëve djegëse që do të përdoren.	Kompania zbatuese e projektit
Emetim zhurmash dhe vibracionesh.	Do të parashikohet me saktësi koha e nevojshme e punës së mjeteve në mënyrë që motorët të mos qëndrojnë ndezur gjatë në mënyrë të panevojshme. Njëkohësisht të gjitha mjetet e punës do të kontrollohen periodikisht në lidhje me gjendjen e tyre teknike, veçanërisht për guarnicionet në mënyrë që zhurmat të mos i kalojnë nivelet e lejuara teknologjike. Operacionet e punës do të kryhen në orët normale të punës.	Kompania zbatuese e projektit
biodiversiteti dhe peisazhi		
Modifikim i pejsazhit egzistues	Mbjellja e nje brezi te gjate pemesh per te minimizuar impaktiv vizual	Kompania zbatuese e projektit në bashkëpunim me Drejtorinë Pyjore në lidhje me llojet që do të mbillen
Dëmtim i mundshëm i foleve kryesisht të harabelorëve, insekteve dhe reptilëve	Duhet të bëhet një inventarizim i detajuar i sipërfaqes para fillimit të punimeve në terren dhe të evidentohet nëse do mund të dëmtohet ndonjë fole aktive.	Kompania zbatuese e projektit

7 PROGRAMI MONITORIMIT

Pjesë e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është edhe Plani i Monitorimit Mjedisor (PMM). Monitorimi do të fokusohet në mbledhjen e të dhënave për të verifikuar parashikimet e ndikimeve dhe efektshmërinë e masave zbutëse të planifikuara.

PMM përcakton gjithashtu mënyrat si do të kryhet monitorimi i ndikimeve mjedisore dhe zbatimi i masave zbutëse gjatë fazës së punimeve. Vëmendja kryesore do të drejtohet në rishikimin e të gjithë propozimeve për punime të reja me ndikim potencial në mjedis për të siguruar zbatimin e tyre në përputhje me normat mbi mbrojtjen e mjedisit.

Monitorimi mjedisor, i cili do të realizohet nga një staf i specializuar, konsiston në:

- *Mbikëqyrje afatgjatë të cilësisë së përgjithshme mjedisore, të kryer në një periudhë afatgjatë dhe mbi një zonë më të madhe se zona e projektit për të vlerësuar efektet që ndodhin edhe pas përfundimit të projektit (Monitoruar dhe nga KKU);*
- *Mbikëqyrje specifike të vendit, afatmesme, të kryer së pari për të parë nëse parashikimi i vlerësimit të ndikimit mjedisor të projektit është i saktë apo jo (pamje ajrore nga lart, depozitim/erozion në vendet e paracaktuara.*
- *Mbikëqyrje të përputhshmërisë operationale afatshkurtër të treguesve të proceseve të zgjedhura operationale që do të përdoren çdo ditë gjatë ekzekutimit të punimeve, të tilla si turbullimi gjatë operationeve të thellimit, prodhim pluhuri e zhurme.*

Mbikëqyrja do të zbatohet sipas një plani të detajuar veprimtarish.

Sipas fazave të projektit duhet të hartohet një program monitorimi me indikatorët përkatës që të tregojnë për presionin që po ushtrojnë në mjedis aktivitetet e zbatimit të projektit. Në fazën e ndërtimit duhet t'i kushtohet rëndësi vrojtimit të ndikimeve të parashikuara mjedisore të projektit si dhe atyre të paparashikuara me qëllim që të adaptohen masa të menjëhershme zbutëse ndaj pasojave të tyre.

Parametrat që do të monitorohen sipas fazave të projektit jepen në tabelën më poshtë:

Faza e funksionimit			
1	Pluhuri dhe zhurmat si pasojë e veprimtarisë së impjantit të prodhimit të betonit	Periodikisht/dokumentim	Zbatuesi i projektit
2	Aksidente kafshësh të egra, zvaranikë etj.	Dokumentim	Zbatuesi i projektit
3	Sasia e mbetjeve të ngurta urbane dhe menaxhimi i tyre	Periodikisht/dokumentim	MM/Organet e pushtetit vendor
4	Trajtimi ujrave që gjenerohen nga aktiviteti	Periodikisht/dokumentim	MM/Organet e pushtetit vendor

8 REKOMANDIME

- Te menaxhohen mbetjet e ngurta ne bashkepunim me Njesine e Qeverisjes Vendore.
- Te sigurohet furnizim i panderprere me karburant per te shmangur nderprerjen e procesit te punes ne impjant
- Te perdoret lende djegese e cilesise se pare per gjeneratorin dhe mjetet e transportit, ku niveli i sqfurit te jete brenda normes se lejuar prej 10ppm.
- Te aplikohet lagia e shesheve te pa shtruara per te reduktuar pluhurin.
- Te mos depozitohet lende e pare ne sasi te medha, per te reduktuar demtimin e peizazhit dhe te erozionit te eres dhe te shiut.
- Te mirembahen mjediset e gjelberuar ne menyre te perhershme dhe te mbillen edhe peme te larta pergjate murit rrethues te kantierit.
- Te kryhet larja e automjeteve te transportit ne menyre periodike.
- Te rrethohet sheshi i ndertimit dhe te zbatohet rregullat e sigurimit teknik .
- Te ndertohet nje grope dekantuese per mbetjet e cimentuara dhe ujrat teknologjike .
- Te evitohen shkarkime prane trupave ujore qofte dhe sezonal
- Investitori te respektoje detyrimet e vena ne Lejen Mjedisore qe do te miratohet nga Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM).
- Subjekti te respektoje te gjitha masat e percaktuara ne kete raport te VNM-se.
- Subjekti te jete ne dijeni te kuadrit ligjor per mjedisin dhe ndryshimeve te tij.
- Te kryhet monitorimi i mjedisit sipas ligjeve ne fuqi dhe te dergohet nje relacion shkresor cdo tre muaj prane Drejtorise Rajonale te Mjedisit.